



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM – ERZEN “TIRANË”**

**VENDIM**

**Nr.3 Dt.07.12 2017**

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË PUS-SHPIMI, RR.”QEMAL STAFA” TIRANË,  
SUBJEKTI “AFËRDITA VORPSI”**

Në zbatim të Ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2; ligjit 111/2015 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar“ neni 8 pika 1, Vendimit Nr. 416 datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor”, Vendimit nr.6 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

**V E N D O S I :**

Miratimin e lejes për hapjen e një pus shpimi për subjektin “**Afërdita Vorpsi**” nga shpuesi profesionist Fatos Kopaçi, Rr.Qemal Stafa, bashkia Tiranë .

1. Koordinatat e vendodhjes së pusit dhe parametrat teknikë:

X=45 78 764            Y=44 01 792            Z=111 M

a. Thellësia e parashikuar 30 -150 m

b. Kapaciteti i parashikuar Q= 0.4-1 l/s

c. Diametri i shpimit 244 mm

2.Ngarkohet ABU Ishëm - Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN**

**SEKRETAR**

Shpëtim MEDIU

**KRYETAR**

Suzana JAHOLLARI

